



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

- Kuvendi Komunal
01 Nr.006-833/4
Dt.23.01.2014
D r a g a s h

Kuvendi Komunal i Dragashit, në bazë të nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 32.2 të Statutit të Komunës-Dragash, konform nenit 6.1 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtëshme të komunës dhe nenit 2.3 të Udhëzimit Administrativ të Qeverisë së Kosovës nr.02/2012 e sipas shkresës-kërkësë të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit nr.130/2014/01 të dt.17.01.2014, lidhur me ndërtimin e palestrës sportive për komunën e Dragashit, në seancën e Kuvendit Komunal të Dragashit të dt.23.01.2014, miratohet ky:

V E N D I M

I. JEPET PËLQIMI për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pjesës së parcelës kadastrale nr.570 në ZK Shajne për realizimin e ndërtimit të palestrës sportive në komunën e Dragashit, të paraparë për investime nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me kapacitet 1 mijë ulëse.

II. AUTORIZOHET Drejtoria për Gjeodezi, Urbanizëm dhe Pronësi i Komunës-Dragash, që, sipas Kërkesës, në bashkëpunim me Ministrinë e lartpërmendur të ndërmarr hapat e nevojshëm për implemmentimin e këtij projekti investues, përfshi këtu edhe pëlqimet e nevojshme nga ministrinë përkatëse të parapara edhe me nenin 3.3 të Udhëzimit të lartpërmendur Administrativ.

III. Për hapat e ndërmarr të njoftohet kryetari Komunës dhe Kuvendi Komunal-Dragash.

A r s y e t i m

Duke u bazuar në nevojat reale, që edhe komuna e Dragashit të ketë palestër sportive siruse shumica e komunave të Kosovës, nga kryetari i komunës Dragash dhe drejtoria, paraprakisht, janë bërë kërkesa Ministrisë së Rinisë, Kulturës dhe Sportit për realizimin e këtij projekti investues nga ana e Ministrisë. Prandaj, duke u përkrah kjo kërkesë si nevojë dhe dëshirë e strukturave komunale dhe mbar popullatës së Komunës së Dragash u vendos si në pikat I dhe II të këtij Vendimi të KK-së Dragash.

I dërgohet:

- Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit-Prishtinë,
- Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport-Dragash,
- Drejtoria të Urbanizmit, Gjeodezisë e Katastrit-Dragash,
- Kryetarit të Komunës-Dragash, dhe
- Arkivit



Kryesuesi i KK-së-Dragash
Shaban Shabani

(Signature)